

Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. Hyrje dhe prioritetet e misionit

1. Ky raport dorëzohet në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përmes së cilës Këshilli themeloi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe kërkoi nga Sekretari i Përgjithshëm që të raportoj në periudha të rregullta kohore për zbatimin e mandatit të tij. Në këtë raport mbulohen aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet lidhur me to, duke filluar nga data 16 mars deri më 15 shtator 2021.
2. Prioritetet e misionit mbesin avancimi i sigurisë, stabilitetit dhe i respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe regjion. Në çuarjen përpara të këtyre objektivave, UNMIK-u vazhdon angazhimin e tij konstruktiv me Prishtinën dhe Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe me palët regjionale e ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë me ushtrimin e roleve të tyre brenda kornizës së Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit. Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) vazhdon praninë e tij në Kosovë në përputhje me deklaratën e kryetarit të Këshillit të Sigurimit, të datës 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), dhe me raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, të datës 24 nëntor 2008 (S/2008/692). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara bashkëpunojnë ngushtë me misionin.

II. Zhvillimet kryesore politike dhe të sigurisë

3. Pas zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në Kosovë më 14 shkurt, ku Lëvizja Vetëvendosje fitoi shumicën parlamentare, në kuadër të zhvillimeve kryesore politike hynë formimi i qeverisë së re dhe rifillimi i dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian mes Beogradit dhe Prishtinës. Më 22 mars, Kuvendi zgjodhi kryetarin e Vetëvendosjes, Albin Kurtin, si kryeministër të Kosovës, ndërsa më 4 prill zgjodhi Vjosa Osmanin (iniciativa Guxo) si presidente të Kosovës, e cila njëherësh është gruaja e dytë në Kosovë që mban këtë post. Duke marrë parasysh se pandemia COVID-19 është ende duke prekur rëndë Kosovën, qeveria e re ka prioritetizuar rimëkëmbjen nga pasojat shëndetësore, shoqërore dhe ekonomike të pandemisë. Përderisa qeveria e re morri për bazë thirrjet e palëve ndërkombëtare për trajtimin me prioritet të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, në dy takimet e nivelit të lartë të mbajtura me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian janë shpërfaqur dallime më të mëdha mes palëve.
4. Qeveria e Vetëvendosjes, e formuar me përkrahjen e të gjitha grupeve parlamentare të komuniteteve joshumicë në Kuvendin e Kosovës, me përjashtim të Listës Serbe, përbëhet nga kryeministri, tre zëvendëskryeministra, dy nga të cilat janë femra, dhe nga kabineti prej 15 ministrish, pesë nga të cilat udhëhiqen nga femrat. Përkundër një kontradikte fillestare, të nxitur nga Lista Serbe që kërkonte më shumë se një ministri, ku më 29 mars e dërgoi çështjen edhe në Gjykatën Kushtetuese, përbërja e qeverisë pasqyron përfaqësim më të madh të komuniteteve joshumicë. Për herë të parë, pjesëtari i komunitetit boshnjak është

në nivel të zëvendëskryeministrit, ku kemi edhe tri ministri që udhëhiqen nga përfaqësuesit e Listës Serbe, si dhe të komunitetit egjiptas e atij turk. Deri në fund të kësaj periudhe raportuese Gjykata Kushtetuese nuk ka nxjerrë vendimin lidhur me çështjen e ngritur nga Lista Serbe. Beogradi ndërkaq ka kundërshtuar përfaqësimin e zvogëluar të kësaj partie në qeveri krahasuar me mandatet e kaluara parlamentare.

5. Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lista Serbe kanë bojkotuar zgjedhjen e presidentes Osmani më 4 prill. Ajo mori 71 vota, ndërsa 11 deputetë abstenuan. Kuorumi i kërkuar prej 80 deputetësh (nga gjithsej 120 deputetë) u arrite vetëm, pasi tre deputetë nga partitë opozitare, duke kundërshtuar partitë e tyre, vendosen të marrin pjesë në sesion së bashku me Vetëvendosjen dhe iniciativën Guxo, Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe grupin shumetnik të komuniteteve të tjera joshumicë.
6. Më 17 maj, kryeministri Kurti paraqiti në Kuvend programin e tij qeverisës, ku menaxhimi i pandemisë COVID-19 u caktua si prioritet kryesor i qeverisë, i pasuar nga trajtimi i çështjeve socio-ekonomike, posaçërisht i papunësisë, dhe i reformës në drejtësi. Së bashku me planet për arritjen e imunizimit të 60% të popullatës deri në fund të vitit 2021, në program parashihet krijimi i fondit për lehtësimin e investimeve të huaja, dhe një proces i ri i vetingut i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Brenda 100 ditëve të para të saj, qeveria e re ndërmori hapa për trajtimin e shkeljeve të pretenduara të detyrës zyrtare, të cilat çuan në shkarkimin nga Kuvendi i Kosovës të bordeve të drejtorëve të disa ndërmarrjeve publike, duke përfshirë Radio Televizionin e Kosovës, dhe institucione të tjera publike. Shkarkimet nxitën kritika të partive opozitare, të cilat i kuptuan ato si të motivuara politikisht. Përkitazi me marrëdhëniet me Beogradin, qeveria e re e Kosovës u zotua që të “bëjë çdo përpjekje për arritjen e njohjes së ndërsjellë”, që të sigurojë parimin e reciprocitetit, si dhe ka shprehur qëllimin për hapjen e rastit kundër Serbisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për krimet e pretenduara të bëra në Kosovë, duke përfshirë edhe pretendimin për gjenocid.
7. Gjatë periudhës raportuese gjithashtu u shënuar një intensifikim i përpjekjeve të Prishtinës për zgjerimin e angazhimit të saj në skenën ndërkombëtare dhe në forumet shumëpalëshe. Më 21 maj, qeveria e Kosovës miratoi Marrëveshjen për lirinë e lëvizjes të qytetarëve dhe palëve të treta, ku parashihet udhëtimi pa viza me Shqipërinë, Bosnje Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Marrëveshja, për të cilën nevojitet miratimi i Kuvendit të Kosovës, ishte njëri nga rezultatet e takimit regional brenda kornizës së Procesit të Berlinit të ministrave të Punëve të Brendshme dhe të Sigurisë, të mbajtur në Shkup, Maqedoni e Veriut, më datën 16 tetor 2020. Qeveria e Kosovës nga ana tjetër vazhdoi me kundërshtimin e nismës së Mini Shengenit, të filluar në tetor 2019 nga udhëheqësit e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, e cila i rimërua në takimin e tyre në Shkup më 29 korrik si nisma e Ballkanit të Hapur. Kjo nismë ka për qëllim të krijimin e një zone të lirë ekonomike dhe të tregut të përbashkët të punës deri në vitin 2023. Prishtina konsideron se kjo nismë nuk ofron status të barabartë për Kosovën dhe se rrezikon marrëveshjen për Tregtinë e Përbashkët Regjional (TPR), të cilën e kanë nënshkruar të gjithë liderët e regjionit, duke përfshirë Kosovën, në samitin e procesit të Berlinit, të mbajtur në Sofje në vitin 2020, dhe përmes së cilës tentohet të arrihet lëvizja e lirë e njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit në regjion në bazë të standardeve të Bashkimit Evropian.

8. Pas formimit të saj, qeveria gjithashtu filloi me përgatitjet për rifillimin e dialogut me Beogradin, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Në përpjekje për arritjen e konsensusit rreth qëndrimit të Prishtinës në dialog, gjatë muajit maj, kryeministri Kurti mbajti takime konsultative me udhëheqësit e opozitës, gjegjësisht me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës dhe me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Të dy partitë shfaqen përkrahjen për negociata me kusht që territori, rendi kushtetues dhe karakteri unitar i Kosovës të ruhen. Partia Demokratike e Kosovës nuk mori pjesë në takimet konsultative, por u deklarua si mbështetëse e vazhdimit të dialogut. Nga ana e saj, Lista Serbe shprehu shqetësimin se autoritetet e reja të Prishtinës nuk ishin të gatshme për të pranuar marrëveshjet paraprake, të arritura në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.
9. Më 15 qershor, pas konsultimeve me partitë politike, presidentja Osmani shpalli 17 tetorin 2021 si datë të zgjedhjeve të ardhshme komunale. Kësaj shpallje i parapriu shkarkimi i kryetares së Komisionit Zgjedhor për “parregullsitë” gjatë zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare të 14 shkurtit, lëvizje kjo që nxiti kritika të partive opozitare dhe organizatave të shoqërisë civile në Prishtinë.
10. Gjatë kësaj periudhe raportuese u shënua rritje e tensioneve dhe u raportuan disa raste të incidenteve, posaçërisht të atyre ndaj komunitetit serb dhe vendeve ortodokse fetare e kulturore serbe. Pas disa pretendimeve për ngacmime, shqetësime dhe vjedhje, një grua serbe që ishte kthyer në Gjakovë më 9 qershor, ishte marrë nën mbrojtjen e policisë së Kosovës. Më 9 gusht, një mashkull serb raportohet të jetë sulmuar nga tre individë të panjohur në komunën e Novobërdës. Rastet e tjera të raportuara kishin të bënin me një sulm të ndodhur më 1 korrik ndaj një djali serb në fshatin Gojbulë të komunës së Vushtrrisë, nga një grup i të rinjve shqiptarë dhe të një sulmi tjetër ndaj një serbi nga disa meshkuj shqiptar më datën 13 prill. Gjatë kësaj periudhe raportuese gjithashtu janë regjistruar gjithsej 15 incidente ndaj vendeve fetare dhe kulturore serbe, duke përfshirë vjedhjet, dëmtimin e pronës dhe murale të urrejtjes. Më 21 korrik, Gjykata themelore në Prishtinë shpalli një qytetar të Malit të Zi fajtor për nxitje të urrejtjes dhe jotolerancës lidhur me pretendimet për brohoritjen e sloganeve nacionaliste serbe gjatë mbledhimit fetar ortodoks serb në Kosovë, më datën 28 qershor, me rastin e shënimit të Vidovdanit. Këtij individ i është ndaluar hyrja në Kosovë për pesë vite dhe i njëjti është dënuar me gjashtë muaj burg apo me pagesë të një gjobe. Arrestimi i tij nxiti protesta në Podgoricë, Mal të Zi, dhe është dënuar nga Zyra e qeverisë së Serbisë për Kosovë.
11. Më 17 korrik, Ministria e Punëve të Brendshme deklaroi se 11 shtetas të Kosovës (6 meshkuj, 1 grua dhe 4 fëmijë) janë riatdhesuar nga Republika Arabe e Sirisë për në Kosovë. Departamenti special i Gjykatës themelore në Prishtinë i dërgoi gjashtë meshkujt në mbajtje, ndërsa femra e kthyer në burg shtëpiak, nën dyshimin për organizim dhe pjesëmarrje në grup terrorist. Ministria gjithashtu deklaroi se të gjithë të kthyerit kanë marrë trajtimin e duhur mjekësor.
12. Nga data 29 gusht deri më 3 shtator, Miroslav Jenča, ndihmëssekretari i përgjithshëm për Evropë, Azi Qendrore dhe kontinentin e Amerikës i Departamentit për çështje politike, të paqeruajtjes dhe të operacioneve paqeruajtëse, ka vizituar UNMIK-un. Ai u takua me zyrtarët qeveritarë, udhëheqësit komunalë, palët ndërkombëtare dhe me përfaqësuesit e shoqërisë civile në Prishtinë, Mitrovicë e Beograd, ku shprehu solidaritetin

dhe përkrahjen e Kombeve të Bashkuara lidhur me përpjekjet për tejkalimin e pandemisë COVID-19, për fuqizimin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit dhe për avancimin e krijimit të besimit dhe pajtimit mes komuniteteve.

III. Ndikimi i sëmundjes së virusit korona (COVID-19) dhe reagimi ndaj saj

13. Gjatë periudhës raportuese Kosova vazhdoi të jetë e prekur nga pandemia COVID-19, ku vala më e madhe e infektiveve të reja u regjistrua në gusht dhe kur numri i vdekjeve në ditë arriti në 36, kur rastet e reja u ngritën për 2.500, ndërsa numri i rasteve aktive kaloi shifrën 27.000. Deri në përfundimin e periudhës raportuese, që nga fillimi i pandemisë në Kosovë janë raportuar mbi 163.000 raste të COVID-19 dhe 2940 viktimat.
14. Procesi i vaksinimit në Kosovë ka filluar më 29 mars, ku numri i parë i vaksinave erdh përmes instrumentit Përkushtimi i Avancuar i Tregut për Qasjen Globale në Vaksinën kundër COVID-19. Me 201.420 vakcina të pranuar përmes COVAX-it, me donacionet nga partnerët e tjerë dhe me blerjen e 1.2 milion dozave të vaksinës, qeveria përpaket të arrijë synimin e saj prej 60% të të vaksinuarve deri në fund të vitit. Deri më 12 shtator, 676.755 persona në Kosovë kanë marrë së paku një dozë të vaksinës, ndërsa 357.197 plotësisht janë vaksinuar. Janë krijuar edhe ekipet lëvizëse për të siguruar qasjen në vakcina për komunitetet joshumicë dhe për njerëzit që nuk mund të udhëtojnë lehtë në qendrat e vaksinimit. Përveç kësaj, qytetarët e Kosovës, kryesisht ata të komunitetit serb, vazhduan të vaksinohen edhe në lokacionet e përzgjedhura në Serbi.
15. Për të luftuar rritjen e numrit të infektiveve me COVID-19, në prill qeveria miratoi një numër masash kundër pandemisë dhe ndau 6 milionë euro për rimëkëmbjen ekonomike. Në korrik, Kuvendi i Kosovës shpalli rritjen e buxhetit të Kosovës për vitin 2021 në shumë prej 420 milionë euro me qëllim të financimit të pakos së re për rimëkëmbje socio-ekonomike dhe zbutje të ndikimit të pandemisë. Masat kundër COVID-19 u lehtësuan në fund të qershorit pasi që shkalla e infektiveve shënoi rënie, por prapë kanë hyrë në fuqi në fund të gushtit për shkak të rritjes së infektiveve.
16. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u dhe agjencitë, fondet e programet e Kombeve të Bashkuara kanë vazhduar punën. Përveç masave gjithëpërfshirëse, të ndërmarra më parë, në fund të gushtit UNMIK-u përfundoi fushatën e tij të vaksinimit për punonjësit e OKB-së dhe familjarët e tyre të ngushtë. Deri në fund të periudhës raportuese, kemi pasur një rast të konfirmuar dhe aktiv të infektimit në mesin e punonjësve të Kombeve të Bashkuara dhe familjarëve të tyre të ngushtë, duke e ngritur kështu numrin e përgjithshëm të rasteve që nga fillimi i pandemisë në 202.
17. UNMIK-u, në bashkërendim të ngushtë me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, vazhdoi përkrahjen e institucioneve të shëndetit publik dhe komuniteteve në Kosovë në reagimin ndaj pandemisë. Kombet e Bashkuara në Kosovë kanë mbështetur nismat për të inkurajuar përputhshmërinë me udhëzimet për vaksinim, duke përfshirë përmes komunikimit dhe partneritetit në terren mes Fondit për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar. UNMIK-u shpërndau nëpër komunat e Kosovës ndihmë humanitare dhe pajisje mjekësore të ndërlidhur me COVID-19 me qëllim të plotësimit të nevojave të personave në situata të cenueshme, duke përfshirë viktimat e dhunës gjinore. Përmes kontributit të Bashkimit Evropian, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR)

dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) ofroj qasje për azilkërkuesit dhe emigrantët në informata lidhur me pandeminë, në ndihmë juridike, arsim dhe këshillime psiko-sociale. Gjithashtu, përmes projektit për ndihmë humanitare të financuar nga BE-ja, UNDP-ja rifuqizoj qendrat për punë sociale me qëllim të përkrahjes së 7.700 familjeve të rrezikuara që jetojnë në varfëri të skajshme, duke iu dhënë kuponë mujorë për ushqim, higjienë dhe artikuj të tjerë esencialë.

18. Që nga fillimi i krizës, kapaciteti testues i Kosovës për COVID-19 është dhjetëfishuar, ku Kombet e Bashkuara kanë dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në formë të pajisjeve për mbajtje në funksionim të organeve vitale, materialeve testuese dhe shërbimeve lëvizëse diagnostike. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) vazhdoi me blerjen e pajisjeve mjekësore dhe të barërave që janë thelbësore në luftimin e COVID-19 në emër të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe përkrahu dizajnimin dhe ndërtimin e depozitave të centralizuara për vaksina. Organizata Botërore e Shëndetësisë vazhdoi me përkrahjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të institucioneve të tjera të shëndetit publik përmes trajnimit për diagnostifikimin e COVID-19, parandalimin e infeksionit dhe kontrollin e tij dhe për gjurmimin e kontakteve.

IV. Kosova veriore

19. Në kuadër të përpjekjeve për trajtimin e çështjes së mospagesës së rrymës së harxhuar në Kosovën veriore, më 6 maj, Kuvendi i Kosovës udhëzoi Operatorin e Kosovës për Sistemin e Transmisionit të Energjisë dhe Tregut (KOSTT) që të merr përgjegjësinë për shpenzimet e bëra për gjashtë muajt pasues, ndërsa gjatë së njëjtës periudhë qeveria do të përfshinë katër komunat në veri të Kosovës në sistemin e faturimit të Kosovës. Në vitin 2020, KOSTT u bë anëtar i Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike, duke marrë kështu përgjegjësinë për sistemin e transmisionit në veri të Kosovës nga Rrjeti Elektrik i Serbisë. Në marrëveshjen e vitit 2013 për energjinë, të ndërmjetësuar nga BE-ja, parashihet themelimi i kompanisë së re të energjisë elektrike brenda kornizës ligjore të Kosovës, e cila do të kishte përgjegjësinë për faturim në katër komunat e veriut.
20. Gjatë periudhës raportuese, janë raportuar një numër incidentesh në veri të Kosovës. Më 1 qershor, një grup prej 30 deri 40 të rinjsh që festonin fundin e vitit shkollor, erdhën tek ura kryesore mbi lumin Ibër, duke tentuar të kalojnë nga veriu në jug të Mitrovicës dhe duke brohoritur “Kosova është zemra e Serbisë.” Policia e Kosovës reagoi dhe shpërndau grupin. Më 19 qershor, raportohet se autoritetet e Kosovës kanë kthyer prapa një autobus me pelegrinë serbë që shkonte në Mitrovicë të jugut. Dioqeza e Kishës Ortodokse Serbe e Rashkës dhe Prizrenit ka dënuar këtë incident. Në disa raste, autoritetet e Kosovës kanë refuzuar dhënien e autorizimit për vizita drejtorit të Zyrës së qeverisë së Serbisë për Kosovë, duke thënë se ato vizita shfrytëzoheshin për fuqizimin e strukturave ilegale të përkrahura nga Beogradi. Beogradi ndërkaq ka protestuar ndaj këtyre kufizimeve dhe ka akuzuar Prishtinën për shkeljen e marrëveshjeve të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian lidhur me vizitat e tilla.
21. Më 24 gusht, Gjykata e Apelit konfirmoi aktgjykimin e dhjetorit 2019 të Gjykatës themelore të Prishtinës, ku dënohej Ivan Todosijeviq, deputet i Kuvendit të Kosovës nga Lista Serbe dhe ish-ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, në dy vjet burg për “nxitje

të urrejtjes, përçarjes dhe jotolerancës nacionale, racore, fetare apo etnike” në bazë të pretendimit për mohimin e masakrës së Reçakut në vitin 1999. Lista Serbe dhe Beogradi kanë kundërshtuar këtë dënim, duke theksuar se përbërja e panelit të Gjykatës së Apelit prej vetëm gjyqtarëve shqiptarë paraqiste shkelje të marrëveshjes së parë të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian për parimet e normalizimit të marrëdhënieve, të datës 19 prill 2013, në të cilën parashihet që Gjykata e Apelit të krijoj panele ku shumica e gjyqtarëve do të ishin serbë lidhur me të gjitha rastet në komunat e banuara me shumicë serbe. Kjo është refuzuar nga Ministria e Drejtësisë e Kosovës, e cila, përkundër komenteve të zëdhënësit të Shërbimit për Punë të Jashtme të Evropës se vendimi nuk ishte në përputhje me marrëveshjen, ka ngulmuar se nuk ka pasur shkelje. Vendimi i Gjykatës së Apelit ka rezultuar me bojkotin e përkohshëm të Gjykatës themelore të Mitrovicës nga ana e gjyqtarëve serbë dhe me thirrjet e Listës Serbe e udhëheqësve komunalë serbë për bojkotimin e zgjedhjeve komunale të 17 tetorit. Më 6 korrik, shqyrtimi kryesor gjyqësor për rastin e politikanit serb të Kosovës, Olliver Ivanoviq, i cili është vrarë në Mitrovicë të veriut në janar 2018, ka filluar në Departamentin special të Gjykatës themelore në Prishtinë. Gjatë procedurave, gjashtë të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm ndaj akuzave për vrasje të rëndë si pjesë e grupit të organizuar kriminal.

V. Normalizimi i marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës

22. Pas formimit të qeverisë së re në Kosovë, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë dhe zëvendëspresidenti i Komisionit Evropian, Josep Borrell, si dhe Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian për dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës dhe për çështjet e tjera regjionale të Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajčák, shprehën gatishmërinë e Bashkimit Evropian për të punuar së bashku me Beogradin e Prishtinën në çuarjen e procesit të dialogut në përmblyllje të suksesshme. Përveç kësaj, Franca, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në mes të tjerash, shprehën përkrahjen e tyre për një riangazhim të shpejtë të palëve në dialog.
23. Më 15 qershor, pas një pauze nëntëmuajore të bisedimeve të nivelit të lartë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, u takuan në Bruksel me ndërmjetësimin e z. Borrell dhe z. Lajčák. Në një komunikatë pas takimit, kryeministri Kurti tha se ai kishte dhënë disa propozime, të cilat Beogradi kryesisht i refuzoi. Këtu përfshiheshin transformimi i Marrëveshjes për tregti të lirë në Evropën Qendrore në marrëveshje për tregti të lirë të Evropës Juglindore, ku Kosova do të gëzonte status të barabartë; nënshkrimi i zotimit të përbashkët për mospulmim të njëri-tjetrit; njohja e ndërsjellë dhe reciprociteti dypalësh, duke përfshirë edhe për çështjen e pakicave, me themelimin e këshillit nacional serb të Kosovës, të ngjashëm me Këshillin Nacional të Shqiptarëve në Serbi; dhe zëvendësimin e kryesuesit të Komisionit të qeverisë së Serbisë për persona të zhdukur për shkak të ndërlidhjes së tij në të kaluarën gjatë luftës me Kosovë. Presidenti Vuçiq deklaroi se përpjekjet e Prishtinës gjatë takimit ishin përpjekje për përfundimin e dialogut dhe se nuk është arritur përparim në asnjë çështje, me përjashtim të marrëveshjes për tu takuar përsëri.
24. Gjatë takimit të dytë në Bruksel, më 19 korrik, në bazë të propozimeve të saj paraprake, Prishtina paraqiti një deklaratë gjashtëpikëshe paqësore, ku ftoheshin të dyja palët që të përmbahen nga kërcënimet apo nga përdorimi i dhunës kundër tjetrit; që rreptësisht të respektohen kufijtë e njëri-tjetrit; që të sigurohet reciprociteti në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të pakicave; që të kërkohet zgjidhja paqësore e kontesteve dhe që të përkrahet

procesi i integritimit në Bashkimin Evropian i njëri-tjetrit. Prishtina gjithashtu ka theksuar nevojën për të futur në deklaratë referencën “e ballafaqimit me të kaluarën” si kusht i nevojshëm për dialog. Nga ana e tij, presidenti Vuçiq i cilësoi propozimet e Prishtinës si iracionale, të parapara për ta bërë dialogun të pakuptimtë. Bisedimet e nivelit teknik në Bruksel më 7 dhe 8 shtator nuk kanë dhënë rezultate domethënëse, edhe pse palët raportohet se janë pajtuar për disa hapa përpara për çështjen e personave të zhdukur dhe u pajtuan që të takohen prapë në tetor. Gjatë diskutimeve, është raportuar se Prishtina ka ngritur çështjen lidhur me lirinë e lëvizjes, zbatimin e marrëveshjes për energji dhe sistemin e faturimit të energjisë në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës dhe çështjen e personave të zhdukur. Ata gjithashtu tërhoqën vërejtjen për mosvazhdimin e mundshëm të marrëveshjes së përkohshme për targa pas skadimit të saj më 15 shtator, duke kërkuar që në vend të saj të futet reciprociteti. Beogradi vazhdoi të theksoi nevojën që Prishtina të plotësojë obligimin e saj sipas Marrëveshjes së parë mbi parimet e normalizimit të marrëdhënieve të vitit 2013 lidhur me krijimin e bashkësisë/asociacionit të komunave me shumicë serbe. Duke përshkruar rezultate e takimit, z. Lajčák tha se qëndrimet e të dyja palëve për një numër çështjesh mbasin të largëta nga njëri-tjetri.

25. Më 23 qershor, në pajtim me zotimet për normalizim ekonomik, të dakorduara në Uashington, D.C. më 4 shtator 2020, qeveria e Shteteve të Bashkuara ia paraqiti Beogradit dhe Prishtinës raportin për vlerësimin e shfrytëzimit të resurseve ujore në liqenin e Gazivodës/Ujmanit në veri të Kosovës për nevoja të gjenerimit të energjisë. Në raport janë dhënë disa rekomandime për efikasitetin e shfrytëzimit të resurseve ujore, duke përfshirë përmes rregullimeve për bashkërendim teknik mes Beogradit dhe Prishtinës.

VI. Kthimet, pajtimi, trashëgimia kulturore dhe marrëdhëniet mes komuniteteve

26. UNHCR-ja ka regjistruar 261 kthime vullnetare të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, të cilët kanë qenë të zhvendosur brenda Kosovës dhe jashtë saj. Nga këta të kthyer, 127 ishin femra dhe 134 meshkuj (212 serbë, 28 romë, 10 ashkali, 7 egjiptas dhe 4 shqiptarë). Pas këtyre kthimeve gjithsej numri i pjesëtarëve të zhvendosur të komuniteteve joshumicë që kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme në Kosovë që nga viti 2000 është 28.957, ku përfshihen 14.218 femra dhe 14.739 meshkuj (12.518 serbë, 7.723 egjiptas dhe ashkali, 4.028 rom, 1.878 boshnjak, 1.464 goranë, 1.302 shqiptarë, 21 malazez, 19 turq dhe 4 kroatë të Kosovës). Ende mbasin 15.728 persona të zhvendosur brenda Kosovës (7.242 femra dhe 8.486 meshkuj), si dhe 69.627 persona me nevoja të lidhura me zhvendosjen në regjionin e Ballkanit Perëndimor, nga përafërsisht 200.000 persona të zhvendosur nga Kosova që jetojnë në regjion, shumica prej tyre në Serbi.
27. Kthimi i serbes së parë që nga viti 1999 në Gjakovë, një komunë kjo me njërin prej numrave më të lartë të viktimave civile gjatë luftës së viteve 1998-1999, është pasuar me një numër veprimesh të raportuara kundër saj, duke përfshirë shpërndarjen e peticionit të nënshkruar nga 12 organizata joqeveritare në komunë, ku kundërshtohet kthimi i saj dhe kërkohej dëbimi. Në korrik, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe palët e tjera ndërkombëtare në Kosovë rikujtuan rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të të gjithë të kthyerve dhe ftuan institucionet e Kosovës që në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe komunitetet vendore të ofrojnë mjedis të duhur për të gjithë të kthyerit. UNMIK-u gjithashtu i shqyrtoi procedurat e posaçme relevante të Këshillit për të Drejta të Njeriut lidhur me rastin në fjalë. Në seancën paraprake dëgjimore të mbajtur më 9 gusht, Gjykata

themelore në Gjakovë refuzoi kërkesën e komunës për dëbimin e të kthyerës nga banesa e saj. Seancat e tjera gjyqësore pritet të mbahen.

28. Gjatë periudhës raportuese, autoritetet komunale të Klinës organizuan një numër takimesh me komunitetin shqiptar, serb dhe egjiptas në Krushevë të Madhe që kishin për qëllim përmirësimin e marrëdhënieve mes të kthyerve dhe komuniteteve pranuese. Takimet u organizuan me përkrahjen e UNHCR-së, dhe aty morën pjesë përfaqësuesit e UNMIK-ut, KFOR-it dhe OSBE-së. Më 23 mars, UNMIK-u dhe UNHCR-ja, në bashkërendim me Ministrinë për Komunitete dhe atë të Administrimit të Pushtetit Lokal, organizuan një punëtori përmes internetit me pjesëmarrjen e zyrtarëve vendorë komunalë dhe të tjerë, të cilët kërkuan një rritje të bashkëpunimit mes institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal për të trajtuar sfidat e personave të zhvendosur.
29. Në kuadër të “Procesit të Shkupit”, nismë kjo regjionale e lehtësuar nga UNHCR dhe OSBE për të avancuar zgjidhjet e qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova, gjatë korrikut në mënyrë virtuale u takua grupi teknik i përbërë nga përfaqësuesit e Beogradit, Podgoricës, Prishtinës dhe Shkupit. Ata shqyrtuan progresin në zbatimin e programit për zgjidhje të qëndrueshme, u pajtuan që të hartojnë një plan të përbashkët veprimi dhe të mbajnë takimin e ardhshëm në muajin tetor 2021.
30. UNHCR-ja vazhdoi përkrahjen e komuniteteve ashkali, rome dhe egjiptase në marrjen e dokumentacionit personal dhe në zgjidhjen e çështjes së statusit civil me qëllim të mundësimit të qasjes së tyre në shërbime publike. Ndihma juridike iu është dhënë 63 individëve (36 femra dhe 27 meshkuj) lidhur me regjistrimin e tyre civil, ndërsa 53 individë (7 femra dhe 48 meshkuj) kanë fituar qasje në të shkollim, ndihmë sociale, si dhe në të drejta pronësore e pensionale. UNHCR-ja gjithashtu u ka ofruar përkrahje psiko-sociale 18 viktimave të dhunës gjinore (16 femra dhe 2 meshkuj) nga këto komunitete.
31. Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur kontribute të tjera në fondin e trustit të Kombeve të Bashkuara në mbështetje të komuniteteve ashkali, egjiptase dhe rome, të prekura nga helmimi me plumb në Kosovë, duke e lënë kështu fondin pa mundësi të mbështetjes së nevojave të tyre.
32. Migrimi i përzier në Kosovë ka vazhduar, me gjithsej 729 arritje të reja të regjistruara, nga të cilët 313 kanë parashtruar kërkesë për azil. Diku rreth 200 deri në 300 emigrantë mbesin të paregjistruar jashtë qendrave të pranimit dhe pa qasje në resurset e qeverisë. Dyzet e pesë emigrantë kanë qenë në qendrën e mbajtjes në Vranidoll në Prishtinë, ku shumica prej tyre ishin në gjendje të keqe shëndetësore. Të gjithë azilkërkuesit dhe refugjatët janë përfshirë në planin nacional të vaksinimit për COVID-19, ndërsa UNHCR-ja ka siguruar që ata të marrin ndihmë juridike falas, përkrahje psiko-sociale dhe gjuhësore e të përkthimit falas. Në fillim të shtatorit, autoritetet e Kosovës gjithashtu ofruan strehim të përkohshëm për rreth 1.000 të evakuuar nga Afganistani në bazë të marrëveshjes mes autoriteteve të Kosovës, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe NATO-s.
33. Më 21 maj, presidentja, kryeministri dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës i drejtuan një letër të përbashkët Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO), ku konfirmuan zotimin e Kosovës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe kërkuan heqjen e manastirit të Deçanit, patriarkanës së Pejës, manastirit të Graçanicës dhe

kishës së Shën Premtes nga lista e trashëgimisë botërore në rrezik. Ata gjithashtu kërkuan caktimin e Kosovës si të vetmen palë përgjegjëse për këto vende, dhe shprehën interesimin e Kosovës për anëtarësim në UNESCO. Përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë akuzuan autoritetet e Kosovës se kërkojnë ta bëjnë Kosovën territor etnikisht të pastër shqiptar dhe kërkuan mbrojtjen e trashëgimisë serbe nga sjelljet e papërgjegjshme të institucioneve të Kosovës. Kjo letër erdhi pas shpalljes më 8 prill nga Europa Nostra, organizatë kjo joqeveritare me seli në Hagë që merret me trashëgiminë natyrore e kulturore, se do të përfshijë manastirin e Deçanit në listën e shtatë vendeve më të rrezikuara të trashëgimisë në Evropë. Kjo shpallje nxiti reagime të qeverisë dhe opozitës në Kosovë, të cilët argumentuan se manastiri nuk i plotësonte kriteret për t'u përfshirë në listë. Në sesionin e mbajtur më 16-31 korrik 2021, Komisioni për trashëgimi botërore i UNESCO-s vendosi që t'i mbajë të gjitha vendet e lartpërmendura të trashëgimisë në Listën e vendeve të rrezikuara të trashëgimisë botërore. Përkundër thirrjeve të Kishës Ortodokse Serbe për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 19 maj 2016, përmes të cilit vërtetohen të drejtat pronësore të manastirit të Deçanit në 24 hektarë tokë ngjitur me të, ende nuk ka patur përparime në këtë drejtim.

34. Shërbimi i liturgjisë së parë më 10 qershor në kishën e papërfunduar të Krishtit Shpëtimtar në Prishtinë, e cila është objekt i kontestit pronësor mes Universitetit të Prishtinës dhe Kishës Ortodokse Serbe, ka çuar në protesta të Universitetit të Prishtinës dhe studentëve të tij shqiptarë, si dhe në shkrimin e muraleve të urrejtjes në objektin e kishës.

VII. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut

35. Gjatë periudhës raportuese, në përputhje me prioritetet e qeverisë për fuqizimin e gjyqësorit dhe luftimin e korrupsionit, Ministria e Drejtësisë filloi punën e vetingut të sistemit të drejtësisë të Kosovës dhe hartimin e ligjit për konfiskimin e pronës së fituar në mënyrë të paligjshme. Qeveria gjithashtu miratoi strategjinë dhe planin e veprimit për fuqizimin e sundimit të ligjit për periudhën 2021-2026.
36. Institucionet e Kosovës kanë intensifikuar luftën e tyre kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit që ka rezultuar me numër të rritur të arrestimeve dhe akuzave të ngritura. Prej muajit mars deri në maj, disa operacione të mëdha çuan në arrestimin e mbi 30 të dyshuarve për trafikim me emigrantë, mashtrim, narkotikë dhe tregti ilegale të armëve. Në prill dhe qershor, policia e Kosovës arrestoi 33 punonjës së Ministrisë së Bujqësisë dhe agjencive të ndërlidhura me të për keqpërdorimin e pretenduar të subvencioneve për bujqësi. Në qershor, kryesuesi i Komisionit të Pavarur për Media dhe një zyrtar tjetër janë arrestuar në bazë të dyshimeve për marrjen e ryshfetit. Publikimi në korrik i informatës, ku aludohej për keqpërdorimin e pretenduar të detyrës, shkëmbimin e favoreve dhe keqsjelljes së rëndë rezultoi me dorëheqjen e gjyqtarit të lartë dhe anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe në shkarkimin e drejtorit të Njësisë së Inteligjencës Financiare.
37. Më 14 qershor, kryetari i komunës së Istogut është dënua me një vit burgim për dhënien e tenderit kompanisë që është në pronësi të familjarit të tij, ndërsa ndaj kryetarit të komunës së Klllokotit në korrik është ngritur akuza për krime të lidhura me zgjedhjet. Përveç kësaj, dy akuza të ndara janë ngritur kundër kryetarit të komunës së Malishevës për keqpërdorim të detyrës zyrtare, mashtrim dhe shpëlarje të parave. Më 7 korrik, Zyra e Prokurorit Special e Kosovës ngriti akuzë kundër ish-ministrit për Integritet Evropian dhe katër zyrtarëve të tjerë për keqpërdorim të detyrës zyrtare lidhur me një kontratë me një firmë të huaj konsulente. Më 12 gusht, Gjykata e Apelit vërtetoi akuzën e ish-sekretarit të Ministrisë së

Infrastrukturës dhe tre zyrtarëve të tjerë për keqpërdorim të detyrës zyrtare, shpëlarje të parave dhe korrupsion.

38. Gjykatat e Kosovës gjithashtu kanë nxjerrë aktgjykime për dy raste të krimeve të luftës dhe raste të ndërlidhura. Më 23 mars, Departamenti special i Gjykatës themelore në Prishtinë shpalli dy pjesëtarë të policisë serbe fajtor për krime të luftës, të kryera kundër popullatës civile në vitin 1999 në fshatin Nerodime të komunës së Ferizajt, dhe i dënoi ata me 14 vjet e gjashtë muaj burg, përkatësisht me 7 vjet burg. Po ashtu, një shqiptar është arrestuar në Pejë më 30 mars dhe është dërguar në paraburgim në bazë të dyshimit për krime të luftës kundër popullatës civile në mars të vitit 1999, në fshatin Izbicë të komunës së Skenderajt. Në qershor, pas ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, gjykatat e Kosovës morën juridiksionin *in absentia* për procedurat penale lidhur me shkeljet e pretenduara të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe penale.
39. Qeveria finalizoi dy korniza të ndryshme për monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi dhe zbatimit të të gjitha rekomandimeve të dhëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit i Kosovës me qëllim të avancimit të të drejtave të njeriut. Përkundër disa përparimeve, shumica e rekomandimeve të Avokatit të Popullit mbesin për t'u zbatuar.
40. UNMIK-u filloi një nismë testuese për monitorimin e nxitjes së urrejtjes dhe fjalimeve të urrejtjes në mediat sociale dhe ato në internet në përputhje me strategjinë e Kombeve të Bashkuara dhe Planin e veprimit për fjalimet e urrejtjes, si dhe me Planin e veprimit të Rabatit për ndalimin e promovimit të urrejtjes nacionale, racore apo fetare që përbën nxitje në diskriminim, armiqësi apo dhunë.
41. UNMIK-u vazhdoi të mbështesë përpjekjet për zbardhjen e fatit të 1630 personave të zhdukur (1367 meshkuj dhe 263 femra) që nga ngjarjet e viteve 1998 – 1999 në Kosovë. Më 16 prill, UNMIK-u mori pjesë në takimin e Grupit punues të Prishtinës dhe Beogradit për persona të zhdukur lidhur me ngjarjet në Kosovë, ku ishin edhe përfaqësuesit e familjeve të shqiptarëve dhe serbëve të zhdukur. Në maj kanë përfunduar zhvarrimet në varrezën masive të Kizhevakut në Serbi, me ç'rast ka filluar identifikimi i mbetjeve mortore përmes testimi të ADN-së.
42. Më 18 gusht, qeveria mbajti takimin e parë e grupit punues që ka për detyrë hartimin e strategjisë për drejtësinë tranzicionale, ku përfshihen përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe organizatave të shoqërisë civile. Kjo strategji pritet të pasqyrojë përvojat, nevojat dhe të drejtat e të gjitha viktimave, si meshkujve ashtu edhe femrave. UNMIK-u vazhdoi me avokimin e qasjes me qendër tek viktimat dhe të përfshirjes së të gjitha komuniteteve në procesin e drejtësisë tranzicionale.
43. Në fund të qershorit, pas konsultimeve të gjëra nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Drogës dhe Krimin, me përkrahjen e UNMIK-ut dhe në partneritet me organizatën ndërqeveritare Nisma Regjionale Kundër Korrupsionit (*Regional Anti-corruption Initiative*), autoritetet e Kosovës miratuan udhëzuesin regjional kundër korrupsionit dhe financimit të paligjshëm. Përmes këtij udhëzuesi tentohet që lufta kundër korrupsionit dhe financimit të paligjshëm të vihet në përputhje me kornizat përkatëse të Kombeve të Bashkuara dhe të Bashkimit Evropian.

VIII. Gratë, paqja dhe siguria

44. Që nga themelimi në shkurt të vitit 2018, komisioni i qeverisë së Kosovës përgjegjës për verifikimin dhe njohjen e statusit të viktimave dhunës seksuale të ndërlidhur me konfliktin, ka pranuar 1.528 aplikime. Deri më sot, 987 aplikuesve (949 femra dhe 38 meshkuj) u është dhënë statusi i viktimës, ndërsa 222 aplikues (189 femra dhe 33 meshkuj) janë refuzuar. Më 5 korrik, Departamenti special i Gjykatës themelore të Prishtinës nxori vendimin e parë të këtij lloji kundër ish-pjesëtarit të policisë rezerviste serbe, i cili u shpall fajtor për kryerjen e krimeve të luftës, duke përfshirë dhunimin, kundër popullatës civile në maj të vitit 1999 në komunën e Vushtrrisë. I akuzuari është dënuar me 10 vjet burg, që njëherësh është edhe dënimi i parë për dhunën seksuale të ndërlidhur me konfliktin nga gjykatat vendore të Kosovës. UNMIK-u u ka ofruar aftësi profesionale, këshillime psiko-sociale, ndihmesë juridike dhe kujdes shëndetësor rreth 180 viktimave të dhunës seksuale të ndërlidhur me konfliktin, si dhe ka bërë në video për të ndihmuar luftimin e stigmatizimit të viktimave.
45. Vrasja e fundit të gushtit e një gruaje të re që pretendohet të jetë kryer nga partneri i saj në Ferizaj ka nxitur reagim të qytetarëve dhe një numër marshesh protestuese të grupeve të shoqërisë civile në mbarë Kosovën. Derisa policia e Kosovës kishte arrestuar kryerësin dhe bashkëkryerësin e pretenduar, protestuesit kanë kritikuar sistemin gjyqësor të Kosovës që ka lejuar të dyshuarin kryesor të jetë i lirë përkundër akuzave të mëparshme, duke përfshirë edhe rastin e tentimvrasjes në vitin 2013, për të cilin ai ende nuk është gjykuar. Më 24 gusht, Grupi shumëpalësh për siguri dhe çështje gjinore, i përbërë nga përfaqësues ndërkombëtarë, qeveria dhe shoqëria civile, ftoi institucionet relevante që të ndërministrin veprime konkrete për parandalimin e dhunës kundër grave dhe vajzave, për mbrojtjen e viktimave dhe për ndjekjen penale e dënimit e kryerësve. Institucionet e Kosovës kanë vazhduar të ndërministrin hapa në parandalimin e dhunës kundër grave, duke përfshirë edhe përmes punës së Koordinatorit kundër dhunës në familje dhe të Grupit punues ndërministror kundër dhunës në familje. Gjithashtu ka filluar puna në hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit për mbrojtje ndaj dhunës në familje, si dhe në rishikimin e ndryshimin e ligjeve për ndihmë juridike falas dhe atij kundër dhunës në familje.
46. Më 23 qershor, UNMIK-u dhe Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, organizuan Ditën e hapur globale për gratë, paqen dhe sigurinë në Kosovë, e cila ofroi një platformë për gratë dhe burrat e sektorëve të ndryshëm të shoqërisë për të diskutuar ndikimin joproporcional të pandemisë në shëndetin, shkollimin, punësimin, sigurinë dhe mbrojtjen sociale të gruas. Pjesëmarrësit vunë në pah rëndësinë e sigurimit të pjesëmarrjes së mirëfilltë të gruas, duke përfshirë edhe në rolin udhëheqës, në të gjitha proceset vendimmarrëse lidhur me COVID-19.
47. Më 7 dhe 8 korrik, kryesuesja në detyrë e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe ministrja e Punëve të Jashtme e Suedisë, Ann Linde, dhe ndihmëssekretarja e përgjithshme dhe zëvendës drejtoresha ekzekutive e UN Women, Åsa Regnér, vizituan Kosovën, ku diskutuan mundësitë për avancimin e agjendës së gruas, paqes dhe sigurisë në Kosovë me zyrtarët e lartë qeveritarë, me organizatat e të drejtave të grave dhe me palët ndërkombëtare.

IX. Ndërtimi i besimit, partneriteti dhe bashkëpunimi

48. UNMIK-u vazhdoi të punojë ngushtë me ekipin e Kombeve të Bashkuara për Kosovë dhe me partnerët vendorë e ndërkombëtarë, për të ndihmuar në trajtimin e ndikimit të pandemisë COVID-19 në komunitetet, dhe në avancimin e përpjekjeve për ndërtimin e besimit në mbarë Kosovën.
49. Misioni vazhdoi të mbështesë integrimin e gjyqësorit dhe administrimin e drejtësisë në Kosovë, duke ndihmuar në zvogëlimin e rasteve të pazgjidhura gjyqësore me sigurimin e përkthyesve dhe bashkëpunëtorëve ligjorë, të pajisjeve dhe ndihmës tjetër për Gjykatën themelore të Mitrovicës. UNMIK-u, në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, mbështeti krijimin e një zyre përkthimi të pajisur plotësisht në Gjykatën themelore të Prishtinës, dhe ofroi trajnim për përkthyes të gjykatave. Me mbështetjen e UNMIK-ut dhe EULEX-it, në Qendrën Korrektuese në Lipjan për gratë dhe të miturit u hap një furrë në shkallë industriale, për të shërbyer si qendër e aftësisë profesionale për gratë dhe të miturit e burgosur dhe për të lehtësuar reintegrimin e tyre në komunitete.
50. Qendra e Ndihmës Juridike e Institutit Juridik të Kosovës e mbështetur nga UNMIK-u, ofroi ndihmë ligjore falas për 572 individë (205 femra dhe 367 meshkuj) për çështje që lidhen me të drejtat pronësore, të drejtat e punës dhe pensionistëve dhe dhunën në familje. Më 21 qershor, si pjesë e një projekti të financuar nga UNMIK-u, një organizatë joqeveritare lokale, Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi, mbajti një konferencë virtuale rajonale për të prezantuar një raport mbi qasjen e grave në burimet financiare dhe pronën në Ballkanin Perëndimor, që si sfida kryesore identifikoi mungesën e zbatimit të legjislacionit dhe harmonizimin e praktikave gjyqësore.
51. Më 20 maj, UNMIK-u, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim, prezantoi botimin e shtypur të një fjalori të ri shqip-serbisht dhe serbisht-shqip, i cili për herë të parë gjatë 30 viteve mblodhi së bashku ekspertë gjuhësorë nga Prishtina, Mitrovica dhe Beogradi. Me 40.000 fjalë, është një nga fjalorët më gjithëpërfshirës të këtij lloji. Në korrik, pas disa vitesh avokimi dhe mbështetjeje nga Kombet e Bashkuara, OSBE-ja dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë dhe vendorë, programi i studimeve ballkanistike i Universitetit të Prishtinës u riakreditua për një periudhë trevjeçare si program katërvjeçar i studimeve themelore, duke shënuar një hap të rëndësishëm në promovimin e shumëgjuhësisë në nivelin terciar në Kosovë.
52. Programi i Kombeve të Bashkuara për vendbanimet e njerëzve (UN-Habitat), lehtësoi përdorimin e planifikimit hapësinor për integrim social dhe ndërtimin e besimit duke mbështetur katër administrata komunale në veri të Kosovës, për të avancuar zhvillimin komunal dhe planet e qëndrueshme të lëvizshmërisë urbane që ofrojnë hapësirë për ndërveprim ndëretnik dhe pjesëmarrjen e komunitetit në krijimin e politikave. Pjesëmarrja e komunitetit në hartimin e një harte të lëvizshmërisë kulturore për fshatrat e përziera etnikisht në komunën e Skenderajt, nxiti për herë të parë një vizion të përbashkët të një lagje shumëetnike të bazuar në trashëgiminë e përbashkët kulturore dhe natyrore.

53. Me mbështetjen e UNMIK -ut, në maj një grup organizatash të shoqërisë civile publikuan raportin e tyre të dytë të përbashkët vjetor mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Raporti plotëson një boshllëk në monitorimin dhe raportimin lokal dhe ofron rekomandime konkrete për institucionet e Kosovës për të avancuar realizimin e të drejtave të njeriut. Në prill, UNMIK-u dhe ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë bashkëkryesuan një takim të Grupit punues të OKB-së për të drejtat e njeriut, i cili përfshin partnerë të tjerë ndërkombëtarë në Kosovë, për të rritur koordinimin mbi çështjet e të drejtave të njeriut në kontekstin e krizës COVID-19. UNMIK -u më pas mbështeti miratimin e një dokumenti të avokimit për të ndihmuar në udhëzimin e të gjithë akterëve ndërkombëtarë, në angazhimin e tyre me autoritetet vendore në çështjet e të drejtave të njeriut.
54. Misioni vazhdoi të mbështesë fuqizimin ekonomik të grave dhe nismave multietnike të udhëhequra nga të rinjtë në përgjigje të pandemisë COVID-19. Në partneritet me organizatat lokale të grave, UNMIK-u angazhoi mbi 140 gra në prodhimin e maskave të ripërdorshme të fytyrës për t'u shpërndarë në komunat në të gjithë Kosovën. UNMIK-u gjithashtu mbështeti një seri takimesh të grupeve të fokusit në internet midis zyrtarëve komunalë dhe të rinjve nga komunitete të ndryshme, për të diskutuar shqetësimet specifike të të rinjve dhe mundësitë për bashkëpunim gjatë pandemisë. Përveç kësaj, Misioni financoi një fushatë ndërgjegjësimi në internet, në të cilën ndërtuesit e rinj të paqes u partnerizuan me akterë të ndryshëm për të prodhuar podkaste, video dhe blogje të përqendruara në zgjidhje të sfidave kryesore me të cilat ballafaqohen të rinjtë në Kosovë. Kjo fushatë gjithashtu ofroi edukim mbi të drejtat ekonomike dhe sociale në kontekstin e pandemisë për më shumë se 140 të rinj me prejardhje të ndryshme etnike.
55. Më 25 qershor, Kryeministri i Kosovës dhe koordinatori i Kombeve të Bashkuara për zhvillim, bashkëkryesuan një takim inaugurues të Komitetit të përbashkët drejtues për implementimin e kornizës së bashkëpunimit të Kombeve të Bashkuara për zhvillim të qëndrueshëm për 2021-2025. Kjo kornizë artikulon fushat e bashkëpunimit midis sistemit të zhvillimit të Kombeve të Bashkuara dhe partnerëve të Kosovës në qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm, në përputhje me prioritetet e qeverisë dhe objektivat e integritimit në BE. Qeveria dhe ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë do të monitorojnë së bashku zbatimin e kornizës me pjesëmarrjen e institucioneve qeveritare, UNMIK-ut dhe partnerëve të tjerë vendorë e ndërkombëtarë.
56. UNMIK-u vazhdoi të ofrojë shërbime të certifikimit të dokumenteve për banorët e Kosovës, duke përpunuar 1.969 dokumente të gjendjes civile. Misioni gjithashtu lehtësoi lëshimin e 35 njoftimeve të kuqe, 2 njoftimeve të verdha dhe 11 kërkesave për ekstradim në Kosovë nga anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL), dhe hapi 1.172 raste për hetim brenda bazës së të dhënave të INTERPOL-it. Kjo lë gjithsej 717 raste të hapura që lidhen me territorin ose popullsinë e Kosovës.

X. Vrojtimet

57. Unë mirëpres zotimin e shprehur dhe hapat fillestarë nga qeveria e re e Kosovës për të zbatuar një agjendë ambicioze të reformave, duke pasqyruar mbështetje të fortë për ndryshim në mesin e popullatës së Kosovës. Reforma e mirëfilltë institucionale është një sfidë afatgjate që kërkon angazhim dhe zbatim profesional të fuqive legjislative dhe ekzekutive për të ndryshuar kulturën e qeverisjes. Gjithashtu kërkon përqendrim në një vizion strategjik afatgjatë të bazuar në respektimin e sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe përfshirjes sociale.
58. Po ashtu, mirëpres dialogun e rifilluar midis Beogradit dhe Prishtinës me mbështetjen e Bashkimit Evropian. U bëj thirrje palëve të angazhohen në mënyrë konstruktive, përfshirë zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese, dhe të parandalojnë pengesat në një proces që ka vazhduar për shumë vite. Një qasje e tillë mund t'i japë shpresë një brezi të ri për përparim, duke kapërcyer pengesat në ndërtimin e besimit dhe pajtimit dhe duke i hapur rrugë rihapjes së mundësive dhe bashkëpunimit ekonomik.
59. Miratimi i strategjisë së sundimit të ligjit për vitet 2021-2026 dhe plani shoqëruar i veprimit, janë hapa të rëndësishëm në forcimin e gjyqësorit, gjithashtu përmes vetingut të zyrtarëve në sistemin e drejtësisë, përmirësimit të drejtësisë penale, rritjes së qasjes në drejtësi dhe forcimit të luftës kundër korrupsionit. Ashtu si partnerët e tjerë ndërkombëtarë të Kosovës, Kombet e Bashkuara janë të gatshme të mbështesin objektivat e strategjisë.
60. Gjithashtu u bëj thirrje autoriteteve të Kosovës që të sigurojnë zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e objekteve fetare dhe vendimet përkatëse të Gjykatës Kushtetuese.
61. Unë fuqishëm inkurajoj autoritetet e Prishtinës dhe Beogradit që të marrin pjesë plotësisht në aktivitetet e Grupit të punës për personat e zhdukur në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e familjes, dhe të lënë mënjanë dallimet në procesin e ndriçimit të fatit të të zhdukurve.
62. Gjithashtu kërkoj nga të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetet lokale, të sigurojnë një mjedis të përshtatshëm për kthimin dhe reintegrimin e sigurt, dinjitoz dhe të qëndrueshëm për të gjithë personat e zhvendosur brenda vendit dhe të kthyerit në shoqërinë kosovare.
63. Jam shumë i shqetësuar për incidentet e dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje në Kosovë. Së këndejmi, inkurajoj institucionet qeveritare, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare që të vazhdojnë të avancojnë kornizat ligjore dhe të politikave që trajtojnë dhunën në baza gjinore dhe atë në familje, si dhe të ndërmarrin hapa konkret për të siguruar zbatimin efektiv të tyre.
64. Kombet e Bashkuara vazhdojnë të mbështesin pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në proceset politike dhe në të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe politike në Kosovë, të cilat shpresoj se do të mbeten në krye të agjendës së qeverisë së re.

65. Kombet e Bashkuara mbeten të përkushtuara për të mbështetur të gjitha komunitetet në Kosovë, veçanërisht më të rrezikuarit. Në këtë drejtim, më vjen keq për mungesën e vazhdueshme të kontributeve vullnetare në fondin e mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara, të krijuar për të mbështetur komunitetin ashkali, egjiptas dhe rom në Kosovë, dhe përsëris apelin tim drejtuar shteteve anëtare, akterëve dhe organizatave të tjera për të dhënë kontribute.
66. Në përputhje me rekomandimet e paraqitura në raportin tim mbi *Agjendën tonë të përbashkët*, inkurajoj solidaritetin dhe bashkëpunimin midis institucioneve të Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtarë në luftën kundër sfidave kryesore me të cilat ballafaqohet çdo aspekt i jetës në Kosovë dhe më gjerë, përfshirë dëmet nga pandemia COVID-19, dhe një angazhim për zhvillim të qëndrueshëm dhe luftimin e ndryshimeve klimatike, përfshirë përmes forcimit të bashkëpunimit rajonal.
67. Dëshiroj t'i shpreh mirënjohje Përfaqësuesit tim Special, Zahir Tanin, për udhëheqjen e tij, stafit të Misionit, si dhe Koordinatorit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe agjencive, fondeve dhe programeve të Kombeve të Bashkuara për mbështetjen e tyre të unifikuar në terren. Duke i dhënë përparësi shëndetit dhe sigurisë së gjithë stafit të Kombeve të Bashkuara dhe mbështetjes për komunitetet e Kosovës, Misioni ka siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve të tij dhe mbështetjen drejt zbutjes së pasojave të pandemisë.
68. Gjithashtu shpreh mirënjohjen time për partnerët e kamotshëm, si Bashkimi Evropian, KFOR-i dhe OSBE-ja, për bashkëpunimin e tyre të ngushtë dhe strategjik me Kombet e Bashkuara, që punojnë në solidaritet dhe mbështetje për popullin e Kosovës përballë sfidave komplekse në vazhdimësi.

Shtojca I.

Raport i Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm mbi aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, nga 16 marsi 2021 – 15 shtator 2021.

1. Përmbledhje

Më 18 maj, EULEX-i prezantoi 'Raportin e tij special mbi ndikimin e COVID-19 në sundimin e ligjit në Kosovë', që mbulon periudhën nga marsi 2020 deri në mars 2021, duke identifikuar sfidat kryesore me të cilat përballet drejtësia dhe sistemi korrektues gjatë pandemisë me koronavirusin. Raporti ofron rekomandime konkrete dhe vepruese për institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë për t'iu përgjigjur më mirë krizës së vazhdueshme shëndetësore.

EULEX-i ndihmoi Shoqatën e Grave të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) duke mbajtur kurse trajnimi në internet, dhe mbajti një punëtori dyditore të titulluar 'Forcimi i mëtutjeshëm i stafit femëror në Shërbimin Korrektues të Kosovës', me fokus fuqizimin e stafit femëror të ShKK-së. Kjo ishte ngjarja e parë me prani fizike e zhvilluar në kuadër të projekteve të Misionit pas një pushimi nëntëmujor për shkak të pandemisë.

Në mbështetje të Institutit të Kosovës për Mjekësi Ligjore (IML) në punën e tij për personat e zhdukur, EULEX-i vazhdoi të mbështesë zhvarrosjet në guroren e Kizhevakut në Serbi, lokacion i identifikuar vitin e kaluar me mbështetje të konsiderueshme nga Misioni. IML konfirmoi identitetin e gjashtë personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë dhe eshtrat e tyre ua dorëzoi familjeve.

2. Monitorimi

Monitorimi i rasteve vazhdoi gjatë gjithë pandemisë në vitin 2021. Prania fizike në gjykata dhe takimet me policinë, prokurorinë dhe gjyqtarët u kryen kur ishte e mundur dhe në përputhje me kufizimet në fuqi. Marrëdhëniet e besimit të vendosura prej kohësh me të gjithë homologët vendas siguruan që monitoruesit e EULEX-it të ishin të informuar mirë për të gjitha zhvillimet në çdo kohë, edhe kur kontaktet ishin të kufizuara në telefonata dhe videohirrje.

Që nga krijimi i saj në vitin 2018, Njësia e Misionit për Monitorimin e Rasteve (NjMMR) ka hartuar katër raporte sistematike dhe tematike, të cilat janë ndarë dhe diskutuar me homologët vendas, si dhe me partnerët përkatës ndërkombëtarë. Përveç raporteve sistematike dhe tematike, të cilat Misioni do të vazhdojë t'i prodhojë dhe nxjerrë publikisht në baza të rregullta, EULEX -i harton raporte speciale për çështje dhe aspekte të ndryshme të punës së tij. Në maj, Misioni nisi 'Raportin e tij të veçantë mbi ndikimin e COVID-19 në sundimin e ligjit në Kosovë', duke mbuluar periudhën nga marsi 2020 deri në mars 2021. Ishte raporti i parë që identifikoi sistematikisht sfidat kryesore me të cilat përballet drejtësia dhe autoritetet korrektuese të Kosovës gjatë pandemisë. Raporti përfshin vëzhgime, analiza dhe një sërë rekomandimesh konkrete e të zbatueshme, një pjesë e të cilave tashmë janë adresuar nga homologët vendorë të Misionit. Një shembull është 'Strategjia e Sundimit të Ligjit 2021-2026' e qeverisë, e cila u miratua në gusht. Ajo bazohet në procesin e 'Rishikimit funksional të sundimit të ligjit', që filloi në vitin 2016 me qëllim që të sigurojë një analizë të plotë të problemeve në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë dhe të propozojë mënyra për t'i adresuar ato. EULEX-i e mbështeti këtë proces duke marrë pjesë në grupet e

ndryshme të punës të krijuara për t'u marrë me aspekte të veçanta dhe duke paraqitur pikëpamjet dhe rekomandimet e tij në Ministrinë e Drejtësisë. Gjetjet dhe rekomandimet e 'Raportit Special të Misionit mbi ndikimin e COVID-19 në sundimin e ligjit në Kosovë' janë marrë parasysh.

Duke filluar nga viti 2020, Misioni ndihmoi Njësinë për Hetimin e Krimeve të Luftës (NjHKL) në Policinë e Kosovës (PK) në krijimin e suksesshëm të një baze të dhënash elektronike për krimet e luftës. Baza e të dhënave është një mjet i rëndësishëm për administrimin e lëndëve komplekse penale dhe gjithashtu mundëson analiza cilësore të rasteve. Misioni më tej mbështeti krijimin e bazës së të dhënave duke ofruar disa punëtori trajnimit për stafin e NjHKL-së. Krijimi i bazës së të dhënave u vlerësua pozitivisht nga akterët e tjerë ndërkombëtarë në Kosovë, gjë që rezultoi në mbështetje të mëtejshme për NjHKL-në. Në qershor, Misioni kreu një vlerësim të futjes në përdorim të bazës së të dhënave në bashkëpunim të ngushtë me NjHKL-në, dhe përcaktoi se procesi kishte përparuar shumë pozitivisht, me bazën e të dhënave që përdorej dhe përditësohej rregullisht, që përmbante tashmë më shumë se 400 raste të krimeve të luftës. Përveç kësaj, një gjë tjetër pozitive është se NjHKL filloi hetimet policore në të gjitha rastet e personave të zhdukur dhe filloi t'i lidhë ato me hetimet ekzistuese të krimeve të luftës.

Së bashku me PK-në, Misioni nisi një projekt që synon forcimin e bashkëpunimit midis inspektorëve të mjedisit dhe PK-së me qëllim të forcimit të zbatimit të ligjit në rastet e krimeve mjedisore. Projekti do të nisë në vjeshtë dhe do të zbatohet së bashku nga komuna e Gjakovës, policët vendorë dhe OJQ-të lokale për mbrojtjen e mjedisit.

Misioni i ka përshtatur aktivitetet e tij monitoruese në objektet e ShKK-së me kufizimet e lidhura me pandeminë, duke mbajtur kontakte të rregullta me udhëheqësinë e ShKK-së dhe të njëmbëdhjetë objektet korrektuese, në mënyrë që të jetë në gjendje të vlerësojë mënyrën se si ShKK-ja po menaxhonte sfidat e reja të paraqitura nga COVID-19. Vëmendje e veçantë iu kushtua sigurimit të masave kufizuese të lidhura me pandeminë në institucionet korrektuese, në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare dhe evropiane për respektimin e të drejtave të njeriut dhe trajtimin e kategorive të veçanta, të tilla si të burgosurit e cenusëshëm, të miturit, femrat, ata të profilit të lartë apo të burgosurit e radikalizuar. Vizitat me prani fizike rifilluan në të gjitha objektet sapo një gjë e tillë u bë e mundshme. Misioni rregullisht ndau vëzhgimet dhe rekomandimet e tij se si të merren më së miri me kufizimet që lidhen me pandeminë me udhëheqësinë e ShKK-së dhe me drejtorët e të gjitha objekteve.

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes për nevojën e rritjes së numrit të grave në ShKK, përfshirë edhe në pozitë drejtuese, EULEX-i mbështeti punën e shoqatës së grave të ShKK-së, duke ofruar kurse trajnimit në internet dhe duke lehtësuar kontaktet e shoqatës me akterët përkatës vendorë e ndërkombëtarë, si dhe me shoqata të ngjashme në mbarë botën. Në korrik, Misioni zhvilloi një punëtori dyditore të titulluar 'Forcimi i mëtutjeshëm i stafit femëror në Shërbimin Korrektues të Kosovës'. Punëtorja është pjesë e një projekti të financuar nga Misioni që ofron trajnim dhe fuqizim për stafin femëror të ShKK-së mbi menaxhimin e stresit, komunikimin dhe teknikat e zgjidhjes së problemeve në vendin e punës. Ishte ngjarja e parë me prani fizike e zhvilluar në kuadër të projekteve të Misionit pas një pushimi nëntëmujor të lidhur me pandeminë.

Misioni vazhdoi të mbështesë ShKK-në në adresimin e dy mangësive të mëdha të identifikuara vitin e kaluar, dhe organizoi punëtori trajnimit për stafin e ShKK-së në trajtimin e të burgosurve me probleme të shëndetit mendor dhe planin e emergjencës për rastet e vetëvrasjeve dhe

vetëlëndimeve, të cilat ishin hartuar nga Misioni me kërkesë të udhëheqësisë së ShKK -së. Në korrik, Misioni i dërgoi udhëheqësisë së ShKK-së një raport mbi trajtimin e të burgosurve me probleme të shëndetit mendor në objektet e ShKK-së dhe në spitale. Raporti bazohet në gjetjet e ekspertëve të Misionit gjatë vizitave në objekte të ndryshme, shkëmbimeve me stafin e ShKK -së dhe vëzhgimeve të bëra gjatë serisë së punëtorive për trajtimin e këtij grupi të burgosurish. Raporti përshkruan rekomandimet për ShKK-në, për Ministrinë e Drejtësisë dhe për Ministrinë e Shëndetësisë që të ndryshojnë politikat e tyre përkatëse në trajtimin e kësaj kategorie të të burgosurve, dhe të rrisin kapacitetin e vendosjes për këtë grup në objektet e ShKK -së.

EULEX-i dhe UNMIK-u bashkërisht dhuruan pajisje për një furrë të re buke në Qendrën korrektuese të femrave në Lipjan, e cila u përrua zyrtarisht në fund të korrikut. Furra ka për qëllim fuqizimin e grave të burgosura, duke i trajtuar ato në procesin e prodhimit të bukës dhe ëmbëlsirave dhe në drejtimin e një furre buke, e cila do t'u siguronte atyre mundësi më të mira punësimi pas lirimit nga burgu.

Në mbështetje të Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian për Dialogun Beograd-Prishtinë dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor (PSBE DBP), ekspertët e Misionit vazhduan të mbështesin zbatimin e Protokollit Teknik të MIK (IBM) të arritur brenda kornizës së Dialogut Beograd-Prishtinë të përkrahur nga BE-ja. Duke mos pas komunikim zyrtar midis dy palëve në gjashtë Vendkalimet e Përbashkëta (VP), EULEX-i siguroi kanalin e vetëm të komunikimit përmes vizitave të tij të rregullta në VP dhe kontaktet me të dy palët e autoriteteve. Në korrik, ministri i Punëve të Brendshme miratoi krijimin e një njësie mbi masat dhe procedurat për pranimin dhe përdorimin e Informacioneve të Avancuara të Pasagjerëve (IAP) dhe Regjistrimit të Emrit të Pasagjerit (REP) brenda Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (QKMK), dhe rikrijimin e Grupit të Veprimit dhe Koordinimit të MIK (GVK), i cili nuk kishte funksionuar prej vitesh. Krijimi i Njesisë IAP/REP, si dhe nevoja për të rikthyer GVK ishin avokuar nga Misioni për një kohë të gjatë, dhe EULEX -i mori pjesë në grupin e punës që përgatiste udhëzimin e Njesisë IAP/REP. Këto vendime ministrore janë parësore për ta bërë sistemin funksional dhe përbëjnë një hap të rëndësishëm në harmonizimin e Kosovës me udhëzimet e BE-së për përmirësimin e menaxhimit të kufirit.

Në korrik, Misioni vuri re përmirësime të konsiderueshme në respektimin e marrëveshjeve të arritura në kuadër të Dialogut Beograd-Prishtinë të përkrahur nga BE-ja, mbi mirëmbajtjen dhe renovimin e objekteve në gjashtë Vendkalimet e Përbashkëta (VP) midis Serbisë dhe Kosovës. Avokimi i Misionit me të dyja palët për zbatimin e dispozitave të Protokollit Teknik të IMK si pjesë e Dialogut të mbështetur nga BE-ja, kishte rezultuar vetëm me përparim modest në këtë aspekt specifik gjatë viteve të fundit. Paraqitja e koordinuar e "kontrolleve të lehtësuara të trafikut" nga të dyja palët rezultoi shumë i suksesshëm në adresimin e fluksit të shtuar të automjeteve gjatë periudhës së verës, duke rezultuar në një rënie të konsiderueshme të kohës së pritjes nga të dy palët në krahasim me vitet e mëparshme.

Misioni ofroi mbështetje për Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe për Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC) në procesin e zbatimit të marrëveshjeve teknike për lirinë e lëvizjes, siç është rënë dakord në Dialogun Beograd-Prishtinë, të përkrahur nga BE-ja. Ky mbetet një proces i ngadalshëm dhe i rëndë duke pas parasysh shtrirjen e këtyre marrëveshjeve, si dhe vështirësitë dhe vonesat që vijnë nga ndryshimet e shpeshta të qeverive. Misioni asistoi dhe këshilloi MPB-në dhe ARC-në për vazhdimin e udhëzimeve ekzistuese administrative dhe vazhdimin e vendimeve

ministore që synojnë lehtësimin e njohjes së dokumenteve dhe sigurimin e përjashtimit nga taksat për regjistrimin e automjeteve për serbët e Kosovës. Njohja nga autoritetet kosovare e dokumenteve të lëshuara nga autoritetet serbe (certifikatat e lindjes, të martesës dhe vdekjes, patentë shoferët) dhe lehtësimi i regjistrimit të automjeteve me targa të Kosovës për pronarët e automjeteve me targa të ish -Jugosllavisë ose të ngjashme, janë me rëndësi parësore për të siguruar lirinë e vërtetë të lëvizjes, kryesisht, por jo ekskluzivisht, për popullatën serbe të Kosovës. Një vendim për vazhdimin e këtyre vendimeve dhe vlefshmërinë e targave “KS” është në pritje për gati një vit tani dhe mbetet një pengesë serioze për të siguruar lirinë e plotë të lëvizjes për popullatën serbe të Kosovës.

Misioni vazhdoi të ofrojë vlerësime sipas kërkesës për ekipin e PSBE DBP mbi gjendjen në VP lidhur me përdorimin e dokumenteve përkatëse (pasaportat, kartat e identitetit, patentat e shoferit, certifikatat e regjistrimit të automjeteve dhe dokumentet e hyrjes/daljes).

Misioni vazhdoi të informojë kryetarin e Gjykatës themelore të Mitrovicës, shefin e divizionit të Gjykatës së apelit në Mitrovicë dhe autoritetet e tjera gjyqësore, në mënyrë që të sigurojnë mbështetje në zbatimin e Marrëveshjes së parë të Brukselit dhe Marrëveshjes së drejtësisë, dhe në mënyrë që të sigurojnë krijimin e plotë të mekanizmave të sundimit të ligjit në komunat veriore në Kosovë. Për më tepër, Misioni ndoqi nga afër zhvillimet në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Gjykatën Supreme, Gjykatën e Apelit dhe Ministrinë e Drejtësisë, të cilat kishin ndikim në zbatimin me sukses të marrëveshjeve të lartpërmendura. Misioni në vazhdimësi ka theksuar mangësitë në zbatim, në bashkëpunim të ngushtë me Përfaqësuesin Special të BE -së në Kosovë - PSBE DBP.

3. Operacionet

Funksionet operacionale janë ndërmarrë nga Shtylla e mbështetjes së operacioneve të Misionit, e cila ruan disa kompetenca të kufizuara si reaguese e dytë e sigurisë, dhe ofron mbështetje të vazhdueshme për Policinë e Kosovës në kontrollimin e turmave dhe trazirave përmes këshillave dhe trajnimeve të përbashkëta. Mekanizmi trenivelësh i përgjegjesisë për sigurinë në Kosovë përbëhet nga Policia e Kosovës si e para, Misioni-i i dyti dhe Forca e Kosovës (KFOR-i) si përgjegjësi i tretë i sigurisë.

Misioni ofroi mbështetje për aktivitetet kryesore të Institutit të Kosovës për Mjekësi Ligjore në punën e tij mbi personat e zhdukur. Ekspertët e mjekësisë ligjore të Misionit vazhduan të mbështesin zhvarrosjet në guroren e Kizhevakut në Serbi, një lokacion i identifikuar vitin e kaluar me mbështetje të konsiderueshme nga Misioni. Si rezultat i gjurmimeve në maj, IML zhvarrosi të paktën shtatë persona, duke pritur ende rezultatet e ADN -së për identifikim. Përveç kësaj, gjatë periudhës raportuese, IML-ja konfirmoi identitetin e gjashtë personave të zhdukur të gjetur më parë në lokacione të tjera, dhe eshtrat ua dorëzoi familjeve të tyre.

Misioni vazhdoi mbështetjen e tij për PK-në në fushën e bashkëpunimit policor ndërkombëtar. Meqenëse Kosova nuk është anëtare e Interpolit, Misioni lehtëson shkëmbimin e informacioneve në mes të Njësisë ndërkombëtare koordinuese të PK-së për zbatimin e ligjit dhe zyrave qendrore nacionale të Interpolit nën ombrellën e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Misioni gjithashtu vazhdoi të lehtësojë shkëmbimin e informacioneve midis Europolit dhe PK-së për hetimet e krimeve të rënda përmes zyrës së saj ndërlidhëse suedeze Europol, si dhe midis PK-së dhe autoriteteve serbe, në përputhje me protokollin përkatës midis Misionit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë.

Misioni vazhdoi të mbështesë Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar në përputhje me legjislacionin përkatës të Kosovës.

Shtojca II.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar

Aktiviteti gjyqësor në Dhomat e Specializuara (DhS) vazhdoi të rritet gjatë periudhës raportuese, me dy raste në fazën e procedurës paraprake dhe dy raste që u dërguan në trupat gjykuese. Kryetarja, gjyqtari i procedurës paraprake, panelet gjyqësore dhe panelet e Gjykatës së apelit lëshuan gati 200 urdhra dhe vendime. Njëmbëdhjetë seanca dëgjimore u mbajtën para gjyqtarit të procedurës paraprake dhe tetë seanca dëgjimore para paneleve gjyqësore gjatë periudhës raportuese. Seancat dëgjimore u ndoqën nga palët me prani fizike dhe përmes videokonferencës.

Me arrestimin e z. Pjetër Shalës më 16 mars, janë tetë të paraburgosur në qendrën e paraburgimit të DhS. Z. Shala u arrestua në Belgjikë nga autoritetet belge në bazë të një urdhërarresti dhe aktakuze të konfirmuar të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake të DhS. Z. Shala u transferua në qendrat e paraburgimit të DhS në Hagë më 15 prill dhe bëri paraqitjen e tij fillestare para gjyqtarit të procedurës paraprake më 19 prill.

Më 5 maj, Kryetarja e DhS caktoi trupin gjykues I pas njoftimit nga gjyqtari i procedurës paraprake se dosja e plotë e rastit në procedurat kundër z. Salih Mustafa do të ishte gati për transferim. Më 7 maj, gjyqtari i procedurës paraprake ia transferoi lëndën trupit gjykues I dhe sekretarit i DhS caktoi mbrojtësin e parë të viktimave për të përfaqësuar një grup viktimash në atë rast. Më 18 qershor, trupi gjykues I vendosi që procedurat gjyqësore në rastin Mustafa do të fillojnë më 15 shtator 2021. Ky është rasti i parë para DhS që fillon procedurën gjyqësore.

Më 15 korrik, Kryetarja e DhS caktoi trupin gjykues II pas njoftimit nga gjyqtari i procedurës paraprake se dosja e plotë e rastit në procedurat kundër z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj do të ishte gati për transferim. Më 16 korrik, gjyqtari i procedurës paraprake ia dërgoi lëndën trupit gjykues II. Trupi gjykues ka caktuar që konferencat e para për përgatitjet e gjyqit të mbahen më 1 dhe 2 shtator.

Më 19 mars, gjyqtarët e DhS u takuan përmes internetit për takimin e tyre të gjashtë plenar. Buxheti i DhS dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) për periudhën dyvjeçare, nga 15 qershor 2021 deri më 14 qershor 2023, u miratua nga Këshilli i Bashkimit Evropian më 3 qershor. Gjatë gjysmës së dytë të qershorit, DhS njoftuan për rifillimin e vizitave familjare me prani fizike të të paraburgosurve në DhS nga 15 korriku 2021, në përputhje me këshillat e zyrtarit mjekësor dhe pas fushatës së suksesshme të vaksinimit në qendrat e paraburgimit në DhS. Ky rifillim do të bëhet me faza, duke filluar me anëtarët e ngushtë të familjes dhe më vonë do të zgjerohet në anëtarët e tjerë të familjes nëse kjo fazë e parë shkon mirë.

Deri në fund të gushtit, gjyqtari i procedurës paraprake pranoi 18 aplikantë si viktimë që merrnin pjesë në dy raste.

Lista e disponueshme për publikun e mbrojtësve të specializuar që kanë të drejtë përfaqësimi para DhS përfshin 211 mbrojtës, nga të cilët 100 janë të kualifikuar për të përfaqësuar viktimat. Procesi i aplikimit mbetet i hapur.

ZPS-ja ka vazhduar të intervistojë të dyshuar, viktimë dhe dëshmitarë, si dhe të mbledhë dhe shqyrtojë prova të tjera gjatë periudhës raportuese. Më 20 prill, Prokurori i Specializuar përditësoi Komitetin Politik dhe të Sigurisë të Këshillit të Bashkimit Evropian.

ZPS-ja vazhdon të kërkojë angazhimin dhe mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, të organizatave ndërkombëtare dhe shteteve individuale në të gjitha aktivitetet e saj. Kjo përfshin, në veçanti, sigurimin e shpejtë të dokumenteve të kërkuara nga ZPS për përdorim në gjykatë, dhe lejimin e ish-stafit të misioneve diplomatike ose organizatave ndërkombëtare të përfshira në Kosovë gjatë periudhës së mandatit, për të dhënë deklarata gjithëpërfshirëse të dëshmitarëve dhe për të dëshmuar në gjyq.

ZPS-ja ka kërkuar që të kalojnë në gjykim sa më shpejtë që të jetë e mundur, dhe për këtë qëllim i ka kërkuar gjykatës që të caktojë datat e gjykimit sa më shpejt që të jetë e realizueshme. ZPS-ja gjithashtu ka përmbushur në mënyrë sistematike detyrimet e zbulimit të përcaktuara në Rregulloren e punës dhe të provave të DhS. ZPS ka kundërshtuar me sukses lirimin e përkohshëm, duke argumentuar në një seri regjistrimesh se ekziston një rrezik shumë real që, nëse lirohen të akuzuarit do të tentojnë të pengojnë procedurat gjyqësore dhe të ndërhyjnë tek dëshmitarët.

Masat e lehtësuara të COVID-19 në ambientet e DhS dhe ZPS mbetën në fuqi gjatë gjithë periudhës raportuese. Më 16 mars u bë një vit që DhS dhe ZPS kaluan në punë në distancë, me vetëm një numër të kufizuar të anëtarëve të stafit të lejuar në ambientet për menaxhim të përgjithshëm dhe për të siguruar mbështetje adekuate për vazhdimin e operacioneve. DhS dhe ZPS vazhdojnë të punojnë ngushtë me autoritetet holandeze për të siguruar respektimin e të gjitha masave dhe rekomandimeve kombëtare të shëndetit publik.

DhS vazhduan në mënyrë aktive aktivitetet e tyre në terren gjatë gjithë periudhës raportuese. Videot e DhS në një numër temash të tilla si pjesëmarrja e viktimave u transmetuan 239 herë në 12 kanale televizive në Kosovë. Përveç angazhimit me studentë, praktikantë ligjorë dhe përfaqësues të mediave, aktivitetet e komunikimit me OJQ -të dhe shoqërinë civile vazhduan të zhvillohen gjatë periudhës raportuese përmes konferencave në internet. Më 19 maj, Presidentja dhe ndihmësgjyqtari iu drejtuan një grupi studentësh të fakultetit juridik në Kosovë në mënyrë virtuale, dhe më 23 qershor, ndihmësgjyqtari dhe Prokurori i Specializuar iu drejtuan një grupi përfaqësuesish të shoqërisë civile. Presidentja dhe ndihmësgjyqtari po planifikojnë një vizitë në Kosovë nga 6 deri më 9 shtator, gjatë së cilës do të takohen me një larmi të gjerë anëtarësh të komunitetit diplomatik dhe shoqërisë civile.

Shtojca III

Përbërja dhe numri i komponentës policore të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (më datë 15 shtator 2021)

Shteti	Gra	Burra	Numri
Austria	1		1
Bullgaria	1		1
Finlanda		1	1
Gjermania		1	1
Federata Ruse	1	1	2
Sllovenia		1	1
Turqia		1	1
Mbretëria e Bashkuar		1	1
Gjithsej	3	6	9

Përbërja dhe numri i komponentës ndërlidhëse ushtarake të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (më datë 15 shtator 2021)

Shteti	Gra	Burra	Numri
Çekia		2	2
Polonia		1	1
Republika e Moldavisë		1	1
Rumania		1	1
Turqia		1	1
Ukraina	1	1	2
Gjithsej	1	7	8



The boundaries and names shown and the designations used on this map do not imply official endorsement or acceptance by the United Nations.